

Nr. 1436 Prot
Date 17.03.2026

Procesverbal i mbledhjes se Keshillit Bashkiak date 13.03.2026

Ora 16:00

Salla e mbledhjeve te Keshillit Bashkiak, Njesia Administrative Xhafzotaj, Kati 3

Mungojne:

1. Ardian Kokomani
2. Mentor Kllari
3. Sonila Sinjari
4. Muhamed Mica
5. Myrteza Ramilli
6. Suzana Domi (vonese 15 minuta)

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak): Pershendetje te gjitheve! Meqenese e kemi kuorumin e nevojshem mbledhjen e deklaroj te hapur.

Sulejman Tola (Kryetare I Keshillit Bashkiak): Kjo mbledhje ka rend dite:

1. "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i veçantë, për periudhën 1–31 mars 2026."
PERGJ.SEK NDIHMËS: ATALANTA BALLIU
2. "Mbi miratimin e tavaneve buxhetore afatmesme për vitet 2027-2029 për Bashkinë Shijak".
DREJTORIA EKONOMIKE: PRANVERA ALUSHI

3. "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 112 datë 07.12.2020
"Mbi miratimin e listës (progresive) të familjarëve për përfitimin sipas programit të granteve të rindërtimit dhe projektet model".

DREJTORIA E URBANISTIKES: JONIDA GOGA

4. "Për miratimin e aktekspertizës së thelluar dhe vlerës së rikonstruksionit të banesës individuale me shkallë dëmtueshmërie DS4 – retrofit sipas projektit dhe preventivit përkatës"

DREJTORIA E URBANISTIKES: JONIDA GOGA

5. "Për përditsimin e Programit të Transparencës të Bashkisë Shijak".

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT: DENALDA HOXHA

6. "Për punën e Këshillit të Bashkisë për 12-mujorin e vitit 2025".

SEKRETARI I KËSHILLIT: KOZETA DODA

Kemi dhe një pikë shtesë nga Drejtoria Ekonomiken në rendin e ditës e cila ju shpërnda këshilltarëve pika 7 "Për ndryshimin e VKB nr 56 datë 22.12.2025 për buxhetin e vitit 2026 të

Bashkisë Shijak "Për emërtesë të objekteve të investimit",relaton Drejtoresha Ekonomike Pranvera Alushi.

E hedhim ne votim rendin e dites.

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak):Hapim procesin e votimit per rendin e dites.

Pro:15

Kunder:-

Abstenim:-

Miratohet

Sulejman Tola:Vazhdojme me piken e pare te rendit te dites.

Fjalën ja japim Drejtoreshës Ekonomike Znj.Pranvera Alushi të na relatojë materialin e ndihmës ekonomike në mungesë të përgjegjëses së ndihmës ekonomike Znj.Atalanta Balliu.

Pranvera Alushi :Pershendetje !

Bazuar ne ligjin nr.139/2015 date 17.12.2015 "Per Vetqeverisjen Vendore"

ligjit nr.9936,date 26.06.2008"Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken

e Shqiperise"i ndryshuar,ligjit nr.87/2025 date 12.12.2025"Per buxhetin e vitit 2026"

ligjit nr.57/2019"Per Asistencen Sociale ne Republiken e Shqiperise"si dhe ne baze

te kreut IV pika 3 te vendimit nr.597 date 04.09.2019"Per percaktimin e procedurave

te dokumentacionit dhe te mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimi

te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike",vendimit nr.56 date

22.12.2025"Per buxhetin e bashkise te vitit 2026"si dhe ne baze te vendimit te Keshillit

bashkiak nr.2 date 03.02.2026"Per percaktimin e procedurave te dokumentacionit dhe

mases mujore te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fond

e kushtezuar per ndihmen ekonomike, Këshillit të Bashkisë I Propozojme ,

1.Të trajtojë me ndihmë ekonomike nga të ardhurat e bashkisë me një fond prej 171.100 lekësh , 64 familje, detajuar si më poshtë:

-34 familje në qytetin e Shijakut, me një fond prej 92.400 leke sipas tabelës 1 në material

-21 familje në Njësinë Administrative Xhafzotaj , me një fond prej 55.700 lekë,
sipas tabelës nr.2

-8 familje në Njësinë Administrative Maminas, me një fond prej 20.500 lekë sipas
tabelës nr.3

-1 familje në Njësinë Administrative Gjepale , me një fond prej 2500 lekë, sipas tabelës nr.4

Faleminderit!

Sulejman Tola :Kush ka pyetje ?

E hedhim ne votim .

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak):Hapim procesin e votimit per piken e pare te rendit
te dites.

Pro:15

Kunder:-

Abstenim:-


Miratohet

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak):Vazhdojme me piken e dyte Pranvera.

Pranvera Alushi : Totali i te ardhurave vjen nga tre burime të ardhurash si më poshtë:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen te ardhurat nga taksat (nga taksat vendore, taksat e ndara, nga nga tarifat për shërbimet publike dhe te ardhurat e tjera(gjoba, shitje etj)

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja, transfertat sektoriale. Ne totalin e tyre te ardhurat e tre viteve te PBA vijne ne rritje ne nivelet 3.7 % ,1.6 % dhe 3.8%. Te ardhurat locale jane planifikuar me rritje nga viti ne vit me 19 % per vitin 2025 pasi eshte ne objektivat afatshkurtra mbledhja e detyrimeve te prapambetura te cilat jane nje burim I rendesishem ne te ardhurat locale ,viti2026 eshte planifikuar I njejete me 2025 dhe ne vitin 2027 dhe 4.7 % rritje. Te ardhurat nga burimet qendrore, dhe ne vitet ne vazhdim kemi rritje ne 9 % dhe 2.2 % dhe 2.4 % per vitin 2027. Sic shihet nga tabela peshen me te madhe ne totalin e buxhetit e zene burimet qendrore, ndersa vazhdon raporti 56 % per te ardhurat nga transfertat e pakushteuzuar dhe me 44 % per te ardhurat locale. nga burimet qendrore.Keto burime te ardhurash bashkia I perdor per financimin e funksioneve te percaktuara nga Ligji nr 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore"



Planifikimii te ardhurave nga taksat/tarifat eshte mbeshetur ne paketen fiskale te bashkise Shijak e cila percakton llojet e taksave ,bazen e taksueshme ,kategorizimet dhe nenkategorizimet ,kestet e pagimit,Kohen e kryerjes se tyre,efektet e lehtesive ,strukturat pergjegjese per vjeljen e detyrimeve dhe agjentet tatimore.

Paketa fiskale percakton rregullat per menyren e ushtrimit te drejtave dhe te detyrave nga organet e qeverisjes vendore ,per vendosjen e taksave vendore ,mbledhjen dhe administrimin e tyre.Ne menyre te hollesishme,pervec strukturimit,detajon cdo lloj takse te administruar nga organet vendore te administrimit,percakton qarte dhe administrimin e saj duke filluar me menyren e llogaritjes ,personat pergjegjies te pagimit te takses dhe ato te mbledhjes se saj.

Paketa fiskale e Bashkise Shijak per kete kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me perfshirjen e perfaqsesve te komunitetit te biznesit e me konkretisht biznesit te madh dhe te vogel banoreve te njesive administrative,perfaqsesve te komunitetit sipas interest,keshilltaret etj.,pasqyron disa politika te rendesishme per uljen e disa niveleve ligjore/kufi,etj,sipas kompetencave ligjore,si me poshte:

Politikat incentivuese ne taksa:

- Takse 0 (zero) ndertese per qellime banimi per invalidet
- Zbritje -10%e nivelit te takses per kategorie popullsia
- Nivelin minimal ligjor per taksen e ndikimit ne infrastructure
- Politikat incentivuese dhe uljet nen nivelet e kosto se sherbimit te llogaritur
- Tarife zero per sherbimin e ndricimit public ne zonat rurale
- Tarife zero per familjet dhe pensionistet e vetmuar ,gra kryefamiljare etj
- Tarifa te uleta per familjet me ndihme ekonomike ,familjet me persona invalide

Procesi I planifikimit te ardhurave te veta u realizua ne bashkepunim me administraten e bashkise ,me njesite administrative ,me institucionet e agjentet tatimore ,etj.Vazhdimi I ketij procesi bashkepunues do te mundesoje sigurimin e ardhurave ,me efekt permirsimin e metejshem te sherbimeve qe ofron bashkia ndaj qytetareve te saj,duke raelizuar objektivet madhore ne funksion te zhvillimit te qendrushem ne te gjitha teritorin e bashkise.

Te ardhurat nga burimet e veta vendore perfshijne te ardhurat ngs taksat,te ardhurat nga tarifate dhe te ardhurat nga burimet e tjera.

Zerat e taksave dhe tarifave qe ndikojne ne pjesen me te madhe te planit te ardhurave nga burimet e veta jane kryesisht nga taksat vendore Taksa e nderteses 20% te tij,Taksa e tokes bujqesore 7.7 %,Taksa e ndikimit ne infrastructure per ndertimet e reja 25.4 %,Taksa e mjeteve te perdorura 5 % ,tarifa e pastrimit 19 %.Keto zera mbulojne rreth 77.1 % te planit te ardhurave te bashkise Shijak. Paguesit e nivelit te taksave dhe tarifave vendore jane bizneset ,institucionet dhe familjet e te gjitha njesive administrative.Per percaktimin e numrit te tyre jane

konsideruar te dhenat per tatim paguesit ,si dhe perjashtimet apo lehtesite fiskale sipas paketes fiskale te miratuar nga keshilli bashkiak.

Ne total kapaciteti I tatim paguesve eshte parashikuar rreth 13.384 (familje,biznese dhe institucione) .peshen me te madhe numerike e mbajne familjaret rreth 93.1%.

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak) :Besoj të gjithë ë kanë lexuar materialin është voluminoz mos të zgjatemi shumë.

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak):Ka pyetje rreth ktij projekti?Ska.

E kalojmë në votim.

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak):Hapim procesin e votimit per piken e dytë te rendit te dites.

Pro:15

Kunder:-

Abstenim:-

Miratohet

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak):Meqenëse je aty Pranvera vazhdojmë dhe me pikën e fundit që ishte shtesë në rendin e ditës.

Esta Vora:Kam vetëm për të shtuar dicka.Tek pika e rikostruksioneve,besoj e keni parë tek lagja Kodër sa keq është ajo rrugë.

Pranvera Alushi :Është mbyllur proceduar,është lidhur kontrata ajo rrugë është miratuar që në buxhetin bazë.

Pranvera Alushi:Një material shtesë që kam për të paraqitur për ju është një ndryshim në emërtesë të 3 projekteve të cilave dua tu bëj një përditësim.

Me rishikimin e preventivit të objektit “Sistëmim,asfaltim I rrugëve Eminas-Cizmeli,Njësia Administrative Gjepalaj miratuar në buxhetin bazë nr.56datë 22.12.2025 në vlerën 378,447,413 lekë,u saktësua distanca e rrugës që I përkiste territorit të bashkisë Shijak,pasi një pjesë e tij i përkiste bashkisë Tiranë,dhe kështu këtij objekti I pakësohet fondi në masën 82,985,643 lekë duke e cuar vlerën e tij në 295,488,643 lekë dhe duke saktësuar kështu edhe emërtimin e këtij objekti në Sistemim,asfaltim I rrugëve Eminas dhe Shetel,Njësia Administrative Gjepalaj.

Po kështu kërkojmë saktësim te objektit Rikonstruksion,sistemim-asfaltim rruga”Auto fshati Shetel, Njësia Administrative Gjepalaj me të njejtin fond me emërtesën

Rikonstruksion,sistemim-asfaltim rruga fshati Cizmeli , Njësia Administrative Gjepalaj domosdoshmëri nga problematika e cituar.

Ndërsa objekti I tretë Riparim I shtresave asfaktike rruga Hardhishtë-Gjepalaj, Njësia Administrative Gjepalaj nuk ka ndryshim emërtese por meqenëse zhblllokohen fonde nga objekti I parë u konkludua që këtij objekti ti shtohen edhe degëzimet e lagjeve ku përshkrohet kjo rrugë.pra ky objekt ishte në vlerën 78,000 mijë lekë dhe shkon në shumën 160,985,643 lekë.Buxheti I Bashkisë Shijak për vitin 2026 nuk ndryshon në vlera.

Bashkim Hoxha:Kush është eliminuar nga Cizmeli.Po në Cizmeli do të shkojë lart apo deri tek shkolla.

Jonida Goga:Do të shkojë deri lart në Cizmeli.Thjesht nuk lidhet dot me Ndroqin se nuk është e jona,e ka Tirana.

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak):Ka pyetje rreth ktij projekti?

E kalojmë në votim.

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak):Hapim procesin e votimit per piken e tretë të rendit te ditës.

Pro:16

Kunder:-

Abstenim:-

Miratohet


Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak):Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës.

Jonida Goga: Përshëndetje !

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar ,Aktit Normativ Nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqsisë natyrore” , Vendimit Nr.5 datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga granteve të rindërtimit dhe projektet model” ,Vendimit Nr.282 datë 09.04.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr.5 datë 6.1.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga program i granteve të rindërtimit dhe projektet model” , Vendimit Nr.879 datë 11.11.2020 “Për një ndryshim në vendimin nr.5 datë 06.01.2020 të Këshillit të Ministrave,

Nisur nga Vendimi i Këshillit të Ministrave i cili shprehimisht citon : pika 8 e Kreut II , Projekt model konsiderohet edhe :

a) projekti që realizon vetë subjekti, që kërkon përfitimin e grantit me kusht që të plotësojë kërkesat dhe standartet sipas parimeve të procesit të rindërtimit dhe sipas parashikimeve të këtij vendimi;



b) projekti që realizon vetë subjekti, kur ndërtimi do të realizohet në të njëjtin truall dhe sipërfaqja e truallit nuk lejon realizimin e projektit model, me kusht që të plotësojë kërkesat dhe standartet sipas parimeve të procesit të rindërtimit dhe parashikimeve të këtij vendimi.

Bashkëlidhur është lista me 7 persona të cilët kanë paraqitur kërkesat dhe deklaratat në të cilën kërkojnë që të heqin dorë nga rindërtimi sipas projektit model dhe pretendojnë grantin e projektit individual.

Bashkim Hoxha: Unë jam direkt i prekur nga kjo gjë. Jam vlerësuar 2,5 milion lekë të vjetra. Kush i sheh këto, unë sjam këtu në liste. Kam 3 vite që jam vlerësuar.

Jonida Goga: Për rastet e shembjeve është Instituti i Ndërtimit që na sjell akteespertizën, ne miratojmë vetëm të Institutin.

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak): Ka pyetje rreth këtij projekti?

E kalojmë në votim.

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak): Hapim procesin e votimit për pikën e katërt të rendit të ditës.

Pro: 16

Kunder: -

Abstenim: -

Miratohet

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak): Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës.

Fjala përsëri për ju Znj. Jonida.

Jonida Goga: Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 54, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë dhe Lezhë", i ndryshuar, Aktit normativ nr. 9 datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", dhe me propozim të kryetarit të bashkisë paraqes relacionin shpjegues "Për miratimin e rikonstruksionit të objekteve banesa individuale me shkallë dëmtueshmërie DS4 – retrofit dhe vlerave për rikonstruksionin e tyre sipas projektit dhe preventivit përkatës".

Tërmeti shkatërrues i datës 26 Nëntor 2019, dëmtoi rëndë banesat individuale për të cilat u kryen verifikimet nga grupet e Inspektimit të Bashkisë Shijak dhe nga Instituti i Ndërtimit Tiranë . Instituti i Ndërtimit konstatoi se ashpërsia e dëmtimit dhe shkalla e dëmit nuk paraqet rrezikshmëri më të lartë për shfrytëzim normal pas riparimeve dhe retrofit të mëtejshëm dhe sa më sipër rekomandon:

- Të kryhet projekti konstruktiv dhe arkitektonik për riparimin dhe rikonstruksionin e tij në përputhje me legjislacionin bashkëkohor.

Referuar sa u përmend më sipër , në kuadër të detyrave të lëna nga Instituti i Ndërtimit në Akt-ekspertizën e thelluar , u hartuan projektet për rikonstruksionin e objekteve përkatëse nga studio projektuese e licencuar nga ku rezultoi se:

- Vlera për rikonstruksionin e 1 banese të ndodhur në Territorin e Bashkisë Shijak është 2 617 558 lekë.

Duke qenë se ndërhyrjet për riparimin e strukturës së objekteve të lartëpërmendura kushtojnë afërsisht 50 % e kostos së rindërtimit nga e para të ndërtesës dhe në mbështetje të aktit normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” neni 34, pika 4 ku parashikohet shprehimisht se “Nëse sipas studimit të thelluar, të mbështetur dhe nga opinionca e Institutit të Ndërtimit, ndërhyrjet për riparimin e strukturës kushtojnë më shumë se 70% e kostos së rindërtimit nga e para të ndërtesës, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës vendos shembjen e detyruar të objektit” propozojmë rikonstruksionin e objekteve në fjalë dhe kërkojmë nga ana juaj miratimin e propozimit për rikonstruksionin e objekteve dhe vlerave përkatëse për rikonstruksionin e tyre sipas projektit dhe preventivit përkatës.

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak):Ka pyetje për këtë material ?

E kalojmë në votim.

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak):Hapim procesin e votimit per piken e pestë të rendit te ditës.

Pro:16

Kunder:-

Abstenim:-

Miratohet

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak):Sipas rendit kalojmë në pikën e gjashtë.I japim fjalën drejtoreshës juridike Znj.Albiona Mehmeti.

Albiona Mehmeti: Përshëndetje!Paraqes përpara jush relacionin “Mbi përditsimin e programit të transparencës së Bashkisë Shijak.

Transparenca dhe llogaridhënia janë parime themelore të qeverisjes së mirë dhe të funksionimit të



institucioneve të vetëqeverisjes vendore.

Nëpërmjet transparencës, institucionet vendore garantojnë aksesin e qytetarëve në informacion dhe rrisin besimin e publikut ndaj administratës dhe organeve të zgjedhura vendore.

Në zbatim të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", autoritetet publike kanë detyrimin të publikojnë pa kërkesë një sërë kategorish informacioni që lidhen me organizimin, funksionimin, aktivitetin dhe vendimmarrjen e tyre.

Në kuadër të përmirësimit të transparencës dhe standartizimit të publikimit të informacionit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Urdhrin nr.281, datë 30.12.2025, me të cilin është miratuar Programi Model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Ky urdhër parashikon përditësimin dhe përshtatjen e programeve të transparencës së bashkive në mënyrë që ato të jenë në përputhje me standardet e reja për publikimin e informacionit, strukturimin e tij dhe aksesin e publikut.

Në këtë kuadër, Bashkia Shijak ka ndërmarrë përditësimin e Programit të Transparencës, duke përfshirë kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë, mënyrat dhe afatet e publikimit të informacionit, procedurat për paraqitjen e kërkesave për informim, informacionin mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë, transparencën ekonomiko-financiare, informacionin mbi shërbimet publike, legjislacionin dhe aktet rregullatore si dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje.

Përditësimi i Programit të Transparencës synon rritjen e aksesit të qytetarëve në informacion publik, përmirësimin e komunikimit ndërmjet administratës dhe qytetarëve, si dhe përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe aktet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për sa më sipër, propozohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i përditësimin të Programit të Transparencës të Bashkisë Shijak në përputhje me Urdhrin nr.281, datë 30.12.2025.

Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak):Ka pyetje për këtë material ?

E kalojmë në votim.

Kozeta Doda (Sekretare e Keshillit Bashkiak):Hapim procesin e votimit per piken e gjashtë të rendit te ditës.

Pro:16

Kunder:-

Abstenim:-

Miratohet



Sulejman Tola (Kryetar i Keshillit Bashkiak):Pika e fundit është raporti I këshillit për 12-mujorin e vitit 2025.Ky është një informacion,besoj të gjithë e keni lexuar.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen!

Mbajtësi i Protokollit

Kozeta Doda



Kryetari I Këshillit

Sulejman Tola



Lamturije Keci'



Vjola Syryfa



Dani Keci'

